



Prishtinë, 10 korrik 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1171_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 15.3.2 të Ligjit për Energjinë Termike,
- Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e Nenit 11 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
- Kërkesën e NQ Termokos të datës 08.04.2019 për shqyrtim dhe aprovimin e dokumentit “Propozim Plani Zhvillimorë 2019-2029 i NP Termokos SH.A.”

në seancën e mbajtur me datë 10.07.2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet dokumenti “Plani Zhvillimorë i sistemit 2019-2029 ” i NQ Termokos**

A r s y e t i m


- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 08.04.2019 ka pranuar kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “Propozim Plani Zhvillimorë 2019-2029 i NP Termokos SH.A.”. ZRRE ka analizuar dhe shqyrtuar këtë plan duke dhënë komentet dhe udhëzimet për përmirësim dhe strukturim të këtij dokumenti, dhe pas përfshirjes së komenteve dhe udhëzimeve të ZRRE-së i ka rekomanduar NP Termokos që ky dokument të publikohet për konsultim publik.
- Me datë 07.06.2019 Termokosi ka filluar procesin dy javor të konsultimit publik duke publikuar njohtimin dhe Propozim Planin Zhvillimorë në ueb faqen e vet zyrtare, me çrast ka ftuar palët e involvuara dhe publikun e gjerë për të dhënë komentet – vërejtjet dhe sygjerimet – në këtë dokument.
- Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik Termokosi, në konsultim me ZRRE, ka analizuar komentet e pranuar dhe ka dhënë përgjigjet përkatëse; pas përfshirjes së disa nga komentet e palëve, me datë 10.07.2019 Termokosi ka dërguar Propozim Planin Zhvillimorë final për miratim në ZRRE, të shoqëruar me përgjigjet në komentet e pranuar gjatë konsultimit publik.



4. ZRRE ka analizuar dokumentin dhe vlerëson se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të ngrohjes qendrore të Termokosit dhe se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara.
 5. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, U.D. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Selman Hoti, anëtar

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bashkangjitur:

Plani Zhvillimor 2019-2029 in NP Termokos SH.A.